



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

KRYETARI

Nr. 1840/1 prot.

Vau Dejës, më 23.03.2021

VENDIM

NR 10/1. Date 23/03 /2021

**“PËR CAKTIMIN E VENDEVE TË AFISHIMIT TË MATERIALEVE
PROPAGANDISTIKE PËR ZGJEDHJET PËR KUVEND TË DATËS 25.04.2021”**

Ne zbatim të ligjit 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, të ligjit 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë” (i ndryshuar) ; Udhezimit Nr.06, datë 23.03.2021 ‘Për përdorimin e materialeve propagandistike të edukuese dhe rregullat për afishimin e tyre gjatë fushatës zgjedhore’.

VENDOSA:

1. Vendet e afishimit të materialeve propagandistike zgjedhore të caktohen hapësirat deri në 5 (pesë) metra nga zyra zgjedhore e partisë politike përkatëse, pasi të kenë bërë njoftimin me shkrim Kryetarit të Bashkisë, për hapjen e zyrave zgjedhore dhe për adresat e tyre të sakta.
2. Ndalohet afishimi i materialeve propagandistike në: fasadat e godinave të banimit, institucioneve publike apo ambienteve rrethuese pranë tyre, brenda zonave rekreative, parqeve, në pemët e qytetit apo shtyllat e ndriçimit dhe në mjetet e transportit publik.
3. Në vendet e afishimit subjektet zgjedhore lejohet të afishojnë vetëm materiale të programeve të tyre zgjedhore.
4. Partitë Politike duhet të përmbahen rregullave të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe Udhëzimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
5. Policia Bashkiake dhe Policia e Shtetit të monitorojnë procesin e afishimit si dhe të marrë masa për heqjen e tyre në rast të vendosjes së tyre në kundërshtim me rregullat, sipas funksioneve të caktuara në legjislacionin përkatës.
6. Vendimi nr 10 date dt 18.03.2021, shfuqizohet.
7. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI
MARK BABANI

